

V E N D I M
Nr.242, datë 24.4.2003

**PËR PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT ME TENDER TË HAPUR TË PAKETAVE TË
AKSIONEVE TË SHOQËRISË ANONIME “SERVCOM” FIER, SI DHE KRITERET BAZË
TË PËRZGJEDHJES SË INVESTITORËVE E TË VLERËSIMIT TË OFERTAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë” të ndryshuar dhe të nenit 2 të ligjit nr.8707, datë 1.12.2000 “Për privatizimin e shoqërisë anonime “Servcom””, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përzgjedhja e investorëve strategjikë, që do të marrin pjesë në tenderin e hapur për shitjen e paketës së aksioneve të shoqërisë anonime “Servcom” Fier, në përputhje me vendimin nr.372, datë 27.5.2001 të Këshillit të Ministrave “Për fillimin e procesit të privatizimit e të ristrukturimit dhe për përcaktimin e formës e të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime “Servcom” Fier”, të bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Procedurat e tenderit të bëhen në përputhje me vendimin nr.529, datë 21.8.1998 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e tenderimit të paketave të aksioneve, që zotërohen nga shteti, të shoqërive tregtare” me ndryshimet përkatëse.

3. Vlerësimi i ofertave të investorëve strategjikë të bëhet sipas kriterëve të mëposhtme:

- a. Çmimi i ofruar 85 pikë;
- b. Vlera e investimit 5 pikë;
- c. Plani i biznesit dhe cilësia e tij 5 pikë;
- ç. Cilësia e investorit 5 pikë,

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**KRITERET E PËRZGJEDHJES SË INVESTITORËVE STRATEGJIKË TË INTERESUAR PËR
BLERJEN E PAKETËS SË AKSIONEVE TË SHOQËRISË “SERVCOM”-SHA, FIER.**

Shtojca 1

I. Midis investorëve, që do të kenë dërguar shprehjen e interesit, duke përmbushur kërkesat e treguara në njoftimin publik në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.529, datë 21.8.1998 “Për procedurat e tenderimit të paketave të aksioneve që zotërohen nga shteti, të shoqërive tregtare”, si dhe me ndryshimet përkatëse, ftesa për tender do t’u dërgohet vetëm kandidatëve që përmbushin kërkesat e parashikuara në pikën II, sipas afateve të parashikuara në të.

II. Investorët strategjikë të interesuar, që do të flohen të paraqesin ofertat e tyre të detyrueshme, duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme paraprase:

a. Të jenë persona juridikë.

b. Të kenë një kapital tërësisht të paguar, jo më pak se 5 milionë dollarë ose ekuivalentin e shumës në valutën në të cilën është shprehur kapitali; vlera neto dhe, sipas rastit, vlera neto e konsoliduar duhet të jetë të paktën 10 milionë dollarë.

c. Të jenë shoqëri të specializuara në shërbimet dhe përpunimin e vendburimeve të naftës, të cilat i kanë siguruar këto shërbime gjatë jo më pak se tre vitet e fundit.

Të gjitha këto kërkesa do të vërtetohen nëpërmjet certifikatave zyrtare, të lëshuara nga autoritetet përkatëse ose me anë të dokumenteve të tjera të shkruara, zyrtare.

Palët, të cilat janë në likuidim ose nuk kanë aftësi paguese, janë nën administrim ose procedime të tjera të ngjashme, ose ndonjë procedim që nënkupton një mosaftësi paguese ose

ndërprerje të biznesit, nuk do të pranohen.